



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-4279/1 datë 28.04.2022, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-4279/1 të datës 28.04.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, -----, më datë 28.04.2022 është dorëzuar denoncim me kërkesë drejtuar KSHPK-së në emër të saj për marrjen e dokumentacionit nga një institucion tjetër, pas së cilës u formua lënda numër 12-4279 e vitit 2022.

Në denoncim, parashtruesi thekson se ka dyshime personale për monitorimin e komunikimeve dhe lëvizjeve të tij elektronike dhe të llojeve të tjera, për të cilat kërkon që KSHPK-ja të sigurojë në emër të tij personal një dokument – vërtetim në lidhje me monitorimin, duke përfshirë periudhën kohore dhe qëllimet e monitorimit.

Në datën 30.06.2022, parashtruesi ka dorëzuar edhe një Urgjencë për veprim në KSHPK, e cila është e regjistruar me numër arkivi 12-4279/2.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin bëhet fjalë për pretendime për të cilat nuk ka juridiksion për të vepruar në rastin në fjalë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:

- Parashtruesi

përgatiti: Mr. K.Z

Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska

